



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d), nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), neni 27 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 34 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72, pika 1. e Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34 i dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga DPUKP-ja, nr.-II-1271, të dt.20.09.2022. në mbledhjen e mbajtur me dt.27.09.2022 mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për objektet të cilat gjenden në Parcelën Kadastrale P-72614055-00631-24 në Zonën Kadastrale në Obiliq

Neni 1

Shpallja e interesit të përgjithshëm publik bëhet për shpronësimin e objekteve të cilat gjenden në kuadër të pronës së paluajtshme të Komunës si në vijim :

- **P-72614055-00631-24**, Lloji i Njesisë: Parcel; Lloji i pronës: Pronë shoqërore; Zona: Urban; Vendi i quajtur: Novi Obiliq; Lloji i shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore; Shfrytëzimi actual i parcelës: Kullosat; Kualiteti i klasës: Kullosë e klasës 1; Sipërfaqja 1843 m²; Lloji i Shfrytëzimit të Parcelës: Tokë Ndërtimore; Shfrytëzimi actual i parcelës: Shtëpi – Ndërtesë; me sipërfaqe: 19 m², sipërfaqja e përgjithshme 1862 m². Pjesa e Pronës 1/1; zona kadastrale: Obiliq e cila evidentohet në emër të **PSH. SHFRYTËZ.SHK.FILL. VËLLAZNIMI**.

Neni 2

Në parcelën e përshkruar sipas nenit 1 nr.**P-72614055-00631-24**, janë të ndërtuara 5 (pesë) objekte afariste, 1 (një) me etazhitet P dhe 4 (katër) me etazhitet P+1K .

Ky lokacion apo këto objekte njihen si Qendra Tregtare Obiliq të cilat gjenden në qendër të qytetit të Obiliqit e të cilat në anën juglindore kanë qasje në rrugën “Adem Jashari” në anën verilindore në rrugën “Xhevë Lladrovi” dhe në anën perëndimore në rrugën “Durrësi

Neni 3

Qëllimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të objekteve të cekura si në nenin 2 të këtij Vendimi është Shpronësimi i këtyre, për shkak se teknikisht janë në gjendje jo të mirë po ashtu janë edhe jashtë funksionit për veprimtarinë e destinuar dhe paraqesin rrezik për banorët, ku pas shpronësimit të këtyre objekteve, të njëjtat do të rënohen dhe në parcelën nr.**P-72614055-00631-24** Komuna në të ardhmen do të ndërtoj një park për banorët e kësaj zone.

Neni 4

Vlera e kompenzimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin .

Neni 5

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban,Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës (Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban,Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Drejtoria e Financave .

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

Këtij Vendimi ia bashkangjesim:

- Çerifikatën Pronësore dhe Kopjen e Planit .

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- MAPL
- DPUKP
- DEFZH
- Arkivit

